



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 06, datë 02.02.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“PORTI MBM”, ME VENDNDODHJE NË PORTO ROMANO, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28, dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë konçesionare “Porti MBM”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Porti MBM”, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, datë 12.04.2017, me subjekt zhvillues shoqërinë konçesionare “Porti MBM”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, datë 12.04.2017, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit, i cili përfshin ndryshimet në projekt të miratuara sipas këtij Vendimi, do t’i jepet subjektit kërkues vetëm pas amendimit të kontratës së konçesionit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas legjislacionit sektorial në fuqi, si dhe plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**MINISTËR I LINJËS**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**  
**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**LEDIA TOTA**

